UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI JURIDIK

Agim Ramadani, pn., 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381-38-229 063, 220 484 • email: juridiku@uni-pr.edu• URL: http://www.uni-pr.edu

Dekani:
Prof.Ass.Dr. Avni Puka

Nr.prot: 02/34
Datë: 19.02.2021

Në bazë të nenit 118 paragrafi 5 i Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me 10.02.2021, Këshilli i Fakultetit Juridik, nxjerr:

VENDIM
Për kriteret e paraqitjes, vlerësimit dhe mbrojtjes së temave master

1. Një (1) vit para arritjes së moshës së pensionimit, profesorët nuk mund të emërohen mentor dhe anëtar të komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e temave të masterit. Për temat që profesorët janë emëruar me herët si mentor ose anëtar të komisionit, vazhdojnë deri në arritjen e moshës së pensionimit.

2. Profesori i angazhuar në mësimdhënie pas moshës së pensionimit, mund të mentoroj më së shumti pesë (5) tema të masterit për një vit akademik. Pas arritjes së moshës 68 vjeçare, profesori nuk mund të emërohet mentor apo anëtar i komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e temave të masterit. Për temat që profesorët janë emëruar me herët si mentor ose anëtar të komisionit, vazhdojnë deri në arritjen e moshës 70 vjeçare.

3. Me qëllim të kontrollit të cilësisë së propozimeve të temave të masterit, krijohet Komisioni Këshillëdhënës për Studimet Master, i cili përbëhet nga pesë (5) anëtar, të cilët kanë të paktën gradën e Profesorit Asistent. Komisioni Këshillëdhënës për Studimet Master emërohet nga Dekani.

4. Komisioni Këshillëdhënës për Studimet Master shqyrton Formularin F1, përkatësisht titullin dhe strukturën e punimit të temës master, dhe sipas nevojës mund të propozoj që Formulari F1 të kthehet për rishqyrtim në katedër, para se tema/F1 të miratohet në Këshillin e Fakultetit. Formulari F1 nga Komisioni Këshillëdhënës shqyrtohet në mënyrë anonime pa u bazuar në emrin (identitetin) e kandidatit/es që ka paraqitur F1, si dhe mentorit. Formulari F1 i dërgohet Komisionit Këshillëdhënës nga sekretaret e katedrave vetëm me një numër/kod.

5. Ndarja e temave të masterit duhet të bëhet në mënyrë proporcionale.

6. Katedrat duhet të respektojnë ndarjen proporcionale të mentorimit të temave master, duke i dhënë përparësi thirrjes akademike me të lartë, bazuar në një shkallëzim për shpërndarjen e temave, sipas kritereve si: publikimet shkencore, mosha, përvoja profesionale dhe gjinia. Ndarja e temave sipas këtyre kritereve mbikëqyret nga shefi dhe sekretari/ja i katedrës, në bazë të raportit të evidencave mujore dhe vjetore.

7. Shfuqizohet vendimi i Këshillit të Fakultetit nr.01/253, datë 10.06.2016.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli i Fakultetit.

Kryesues i Këshillit të Fakultetit

Prof.Ass.Dr. Avni Puka - Dekan